# DËSHMI ARKIVI

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

**A-443095**
VERSIONI 1

> **Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | Skema sesi IUTE zbras fitimin nga Shqipëria, që ju merr konsumatorëve me interesa mbi 30%! - Informo hu siç duhet |
| ADRESA | `https://radar.al/skema-sesi-iute-zbras-fitimin-nga-shqiperia-qe-ju-merr-konsumatoreve-me-interesa-mbi-30/` |
| BURIMI | radar.al |
| GJENDJA | online |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 14 shtator 2026, 12:44:26 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 14 shtator 2026, 12:35:56 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `e7ab49258e1dac0ead21facad14ffe380759ef0abc9a2d29eaee19568717319e` |
| TEKSTI | `96e59a2dc965eb1ba9e0c8a916acd43bf821b450f4745be788e4dea9f9ceb831` |
| PAMJA | `faa5fdc3d6de3d2a28a7d173e3d917d185cdb263a7364fea06827ca94fde9543` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `ac7f734605c04baca3c85c77aba78d998d1db0f924d917a5882c0f02dbabab2d` |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | `0b6439cf09af002acf6ffba878872d12e4fabe601bb852ed9a98adac17b7c4e3` |
| ANKORIMI | submitted — dërguar, ende pa bllok<br>*Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/ac7f734605c04baca3c85c77aba78d998d1db0f924d917a5882c0f02dbabab2d`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

AKTUALITET

# Skema sesi IUTE zbras fitimin nga Shqipëria, që ju merr konsumatorëve me interesa mbi 30%!

SEPTEMBER 14, 2026




Vitin e kaluar Iute në Shqipëri pagoi 1.1 miliardë lekë ose 11.4 milionë euro shpenzime për mëmën e saj në Estori.

Të dhënat nga bilanci zyrtar i kompanisë tregojnë se 605.5 milionë lekë u paguan për shërbime menaxhimi nga mëma, 219 milionë lekë ishin shërbime garancie, ndërsa pjesa tjetër prej 274.3 milionë lekësh janë interesa që Iute në Shqipëri i paguan pronarit estonez si interesa borxhi.

Në një sistem ideal taksimi, ku kapitali taksohet njësoj pavarësisht kufijve, transaksionet e një kompanie me palët e lidhura nuk do të përbënin asnjë shqetësim. Por në botën reale, ka një problem. Shkalla e taksave ndryshon nga njëri vend në tjetri. Në Shqipëri, tatim fitimi është 15 për qind. Por në Estoni ky tatim është zero.

Ky hendek, që ndryshe njihet si arbitrazhi tatimor, i mundëson një kompanie që t'i lëvizë përmes transaksioneve me palët e lidhura, fitimet e saj nga vendet ku ato taksohen tek vendet ku taksa është zero. Kjo është ajo që duket se po bën Iute në Shqipëri.

Të dhënat historike tregojnë se në pesë vitet e fundit shpenzimet që Iute Albania bën për mëmën e saj në Estoni gati janë trefishuar nga 3.96 milionë euro në vitin 2020, në 11.4 milionë euro vitin e kaluar.




Ligjërisht një kompani është e lirshme të kontraktojë shërbime nga kushdo, përfshirë mëma apo kompanitë e grupit të saj. Por pyetja që shtrohet është a janë këto shpenzime për shërbime reale, të bazuara mbi kosto tregu, apo fryhen artificialisht për të ulur fitimin në Shqipëri, ku taksohet me 15 për qind dhe për ta transferuar atë në Estoni, ku taksohet me zero.

Demo

Postimet e reja

Skema sesi IUTE zbras fitimin nga Shqipëria, që...
SEPTEMBER 14, 2026

Kokainë në mish pule "Dimali" nga Brazili/...
SEPTEMBER 14, 2026

"Koha e tij ka mbaruar", Ancelotti konfirmon...
SEPTEMBER 14, 2026

Kriza me pagat e drejtësisë/ Rama-...
SEPTEMBER 14, 2026

Mos e humb

AKTUALITET | SEPTEMBER 14, 2026

Skema sesi IUTE zbras fitimin nga Shqipëria, që ju merr konsumatorëve me interesa mbi 30%!

Vitin e kaluar Iute në Shqipëri pagoi 1.1 miliardë lekë ose 11.4 milionë euro shpenzime...

Skandal me sallamin në dyqanet Conad, thirrje konsumatorëve ta kthejnë mbrapsht

6 milionë euro të Startup Albania: Përfituesit, qokat dhe "problematikët"

Beralb fitoi 15 mln euro nga bakri shqiptar, por po helmon fshatra të tërë me ndotje

Na ndiq

Facebook Instagram
YouTube TikTok

qind dhe për ta transferuar atë në Estoni, ku taksohet me zero.

Të kontraktosh shërbime menaxhimi për 6.3 milionë euro në vit duket si një flamur i kuq. Për më tepër, të dhënat nga bilanci tregojnë se ky zë është rritur me ritme të jashtëzakonshme në 5 vitet e fundit nga 184 milionë lekë në vitin 2020, në 605 milionë lekë vitin e kaluar.

### 📊 Shpenzimet për Shërbime Menaxhimi (Iute Albania ndaj Mëmës)

| Viti Fiskal | Shuma në Lekë (ALL) | Statusi i Raportit / Audituesi |
|---|---|---|
| **2025** | **605,551,819 Lekë** | I audituar (KPMG / Mintos) |
| **2024** | **523,261,898 Lekë** | I audituar (KPMG / Mintos) |
| **2023** | **651,711,378 Lekë** | I audituar (Nexia AL) |
| **2022** | **451,200,000 Lekë** | I audituar (Nexia AL / QKB) |
| **2021** | **312,450,000 Lekë** | I audituar (Grant Thornton / Iute) |
| **2020** | **184,120,000 Lekë** | I audituar (Grant Thornton) |

Kur mbledh vetëm shërbimet e menaxhimit dhe garancisë, i bie që 824 milionë Lekë (afro 8.5 milionë euro) janë transferuar direkt në Estoni si shpenzime operative.

Kjo vlerë është dy herë më e madhe se i gjithë fitimi neto që kompania la në Shqipëri (421 milionë Lekë). Përmes kësaj metode, kompania pakëson fitimin në Shqipëri dhe taksat që duhet të paguajë, edhe pse këto janë të ardhura të fituara në Shqipëri.

Ligjërisht Autoritetet Tatimore kanë të drejtë t'i qëmtojnë me hollësi transaksionet e kompanive me palët e lidhura për efekt të shmangies së taksave. Por trendi i parave që Iute çon tek mëma e saj, duket, në rastin më të mirë, i dyshimtë. Një flamur i kuq, që do të duhet të alarmonte Tatimet./Kapital

interesa mbi 30% | IUTE | konsumatorëve | skema

**SHARE.**

**RRETH NESH**

radar.al

Një shikim i thellë në botën e lajmeve, ku teknologjia dhe profesionalizmi takohen për të sjellë lajmet më të fundit dhe të rëndësishme brenda dhe jashtë Shqipërisë. Një burim i besueshëm për informacionin e saktë dhe analizat gjithëpërfshirëse.

**NIPT:** M47705501A
**Email:** radarlajme@gmail.com
**Kontakt:** +355689008000

**HOROSKOPI**

**Universi ka një surprizë për këto 3 shenja më 14 shtator**

**Një ditë me surpriza në dashuri: Horoskopi për të gjitha shenjat**

**Pak dramë, shumë ndjenja: Horoskopi i dashurisë për këtë javë**

Aleanca për Media Etike
Artikull joetik?
raporto këtu

© Radar.al. dizenjuar nga 1001solutions

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.